



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULTETI I EDUKUMIT

Programi fillor

Syllabus

Të dhëna bazike të lëndës			
Njësia akademike:	Fakulteti i Edukimit / Programi Fillor		
Titulli i lëndës:	Lojërat në Natyrë		
Niveli:	BSc		
Statusi lëndës:	Zgjedhore		
Viti i studimeve:	Viti i tretë / Semestri i shtatë		
Numri i orëve në javë:	2+1 (orë)		
Vlera në kredi – ECTS:	4 ECTS		
Koha / lokacioni:	UP/Fakulteti i Edukimit - Semestri dimëror		
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Asist. Dr. Tomor Çela		
Detajet kontaktuese:	tomor.qela@uni-pr.edu		
Përshkrimi i lëndës	<p>Kursi ka për qëllim avancimin e rolit të nxënësit përmes zhvillimit të aktiviteteve në mësimore në natyrë me qëllim të nxitjes së kuriozitetit, kreativitetit, vëzhgimit dhe zhvillimit të mendimit kritik tek fëmijët. Studentet duhet të pajisen me njohuri si të bëjnë ndërlidhjen e kurrikulës mësimore përmes lojës dhe të mësuarit në natyrë. Në këtë kurs ata do të fitojnë njohuri bashkëkohore mbi organizimin e mësimt në formë të lojërave në natyrë përmes elementeve praktike. Marrë parasysh edhe njohuritë e studentëve të fituara në kurset paraprake, leksionet do të fokusohen po ashtu edhe në zhvillimin e aktiviteteve që kanë për qëllim ndërlidhjen e natyrës me konceptet mësimore, duke i bërë fëmijët protagonist kryesor të interaksionit (ndërveprimit) me natyrën.</p>		
Qëllimet e lëndës:	Lënda është e fokusuar në zhvillimin e aktiviteteve përmes lojërave në natyrë duke realizuar aktivitete praktike në përputhje të plotë me kurrikulen dhe RN.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Pas përfundimit me sukses të kursit studenti do të jetë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Zgjeroj horizontet e tij personale në të kuptuarit e dukurive dhe proceseve të ndryshme ✓ Zhvilloj aktivitete praktike duke rritur aftësitë komunikuese dhe argumentuese ✓ Realizojnë detyrat e tyre përmes praktikës, bazuar në lojëra 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e t' nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike / laboratorike	1	15	15
Punë praktike	0.5	14	7
Kontaktet me mësimdhënësin / konsultimet	1	4	4
Ushtrime në teren	1	4	4
Kollokviume, seminare	2	1	2

Detyra të shtëpisë	1	5	5
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15	15
Përgatitja përfundimtare për provim	1	15	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	1	2	2
Projektet, prezantimet, etj.	1	1	1
Totali			100
05: 25 ≈ 4 ECTS.			
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata inteaktive, puna në grupe, punë individuale, punë në çifte, punë seminarike/projekte. Metodologjia e mësimdhënies që do të zbatohet në këtë kurs do të jetë kryesisht interaktive dhe e orientuar drejt involvimit të studentëve në diskutime. Rëndësi e veçantë i kushtohet aspekteve praktike të shtjellimit të temave konkrete ku studentët do të angazhohen në detyra praktike në lidhje me temat përkatëse. Prezantimet e mësimdhënies do të shërbejnë si pikënisje dhe formulim i kornizës brenda së cilës do të orientohet puna e studentëve.		
Metodat e vlerësimit:	Workshope: Vlerësimi mbështetet në këto aktivitete: 10 % Aktivitete në leksione 10 % Detyrë kursi 10 % Prezantimi i punës praktike 35 % Vlerësimin / kollokviumi I 35 % Vlerësimin / kollokviumi II Pikët (%) Nota; do të kalkulohet në proporcion me nr. e pikëve të mbledhura		
Literatura			
Literatura bazë:	1. Çela T. (2023), dispensë interne “Fëmijët dhe organizimi i mësimit në natyrë”, UP/FE, Prishtinë. 2. Herbert W. Broda, (2011): Moving the Classroom Outdoors 3. Steve Rich (2012): Bringing outdoor science in: thrifty clasroom lessons: NSTA		
Literatura shtesë:	1. Caroline Fiennes, Elizabeth Oliver, Kelly Dickson, Diego Escobar, Amy Romans, Sandy Oliver, 2015: The Existing Evidence-Base about the Effectiveness of Outdoor Learning.ed. edition (December 23, 2013) 2. Peggy Ashbrook ‘Science is simple’ Gryphon House; 58579 th edition (May 1, 2003) 1. CDE, (2008). Mësimdhënia dhe të nxëniti ndërveprues (Histori – Gjeografi), Tiranë. 3. Dr. Bardhyl Musaj, Metodologjia e Mësimdhënies, Tiranë, 2003. 4. DK workbooks ‘ Science, Learn and explore preK’DK Children; Workbook Paul Barron, 2014, Games, ideas and activities for Primary Outdoor Learning – second edition.		
Plani i dizajnuar i mësimit:			
Java	Ligjërata që do të zhvillohet		
<i>Java e parë:</i>	Prezantimi i Syllabusit: Aspektet kryesore të mësimit, përfitimet e të mësuarit në natyrë (ndikimet mjedisore; ajri i pastër, drita e diellit gjatë ditës, qetësia emocionale; zhvillimi fizik, motorik, ushtrime dhe pushimi); liria e shprehjes dhe komunikimit; rreziku dhe sfidat; të mësuarit përmes lëvizjeve; të mësuarit përmes diskutimit. Gjithashtu do të prezantohen shembuj konkret të mësimit në ambiente të hapura; zona e komforditetit të mësimit dhe zhvillimi holistik;		
<i>Java e dytë:</i>	Përshtatshmëria dhe integrimi i kurrikulës me aktivitetet e mësimit në natyrë ¹ : kuptimi i kurrikulës, ndërtimi i një kurrikule koherente, kurrikula dhe nxënësi, roli i		

¹ Giving Evidence www.giving-evidence.com Author: Caroline Fiennes,1 Elizabeth Oliver,2 Kelly Dickson,2 Diego Escobar,2 Amy Romans,3 Sandy Oliver2

	mësuesit në përcaktimin e kurrikulës, auditimit i kurrikulës, kurrikula lëndore njeriu dhe natyra: Materia, vetitë dhe shndërrimet, Bota e gjallë, Proceset fizike; toka, mjedisi dhe gjithësia.
<i>Java e tretë:</i>	Përgatitja për të përdorur ambientet e jashtme dhe përmirësimi i oborrit të shkollës për mësim në natyrë: Fillimi i procesit për mësimin në natyrë; inventari i nevojshëm, idetë për klasën e jashtme, zonët mësimore / takime në natyrë, çanta me elementet e nevojshme për mësim në natyrë, tipet e mësimin në natyrë, historia dhe planet ekzistuese për ndërtesën dhe sitin e klasës në natyrë, bashkëpunimi me komunitetin. Detyrë kursi 1: plani për ndërtimin e një klase në oborrin e fakultetit të edukimit dhe planifikimi i organizimit të mësimin jashtë ambienteve të klasës. Ndarja e grupeve të detyrës së kursit: maksimum 5 studentë / grup.
<i>Java e katërt:</i>	Koncepte kryesore të mësimin në natyrë; në këtë leksion do të shtjellohen karakteristikat kryesore të të mësuarit në natyrë; konceptet themelore të edukimit në natyrë (gjithsejtë 17), përcaktimi i vendndodhjes në natyrë përmes hartës/GPS, multidiciplinariteti i temave për objektet dhe dukuritë natyrore, aktivitetet; shëtitje në natyrë, shembuj nga eksperimente shkencore, përdorim i platformave digjitale / geocaching, kamping. Sfidat; logjistika, moti, siguria, etj.
<i>Java e pestë:</i>	Të mësuarit në natyrë dhe përdorimi i teknologjisë informative; Si teknologjia mund të përmirësojë mësimin në natyrë, përdorimi i GPS dhe Geocaching platforma, përdorimi i pajisjeve për përcaktimin e njësive matëse. Analiza e të dhënave të evidentuara përmes; pajisjeve matëse, GPS-ve dhe geocaching platformës, promovimi i stileve të ndryshme të mësimin me punë jashtë klasës.
<i>Java e gjashtë:</i>	Zhvillimi i programeve të mësimin në natyrë në zonat urbane dhe rurale: Rëndësia e shkollave të vogla në zonat rurale- plotësimi i nevojave të komunitetit, çfarë janë shkollat e vogla dhe përfitimet e tyre për shoqërinë, mësimi i personalizuar dhe vëmendja individuale, të mësuarit në natyrë në mjediset urbane, identifikimi i elementeve të përditshme dhe lidhja e tyre me objektet e dukuritë natyrore.
<i>Java e shtatë:</i>	Vlerësimi i njohurive përmes kollokviumit të parë
<i>Java e tetë:</i>	Fëmijët dhe Infrastruktura e Gjelbër Urbane e përshtatshme për mësimin në natyrë. Si të bëhet identifikimi i infrastrukturës së gjelbër urbane, përcaktimi i hapësirave të përshtatshme për mbajtjen e mësimin në natyrë, përcaktimi i temave të veçanta dhe ndërlidhja e tyre me elementet e infrastrukturës së gjelbër.
<i>Java e nëntë:</i>	Materia, vetitë dhe shndërrimet: Përmes lojërave dhe përdorimit të lodrave identifikon dhe hulumton materialet natyrore dhe artificiale që përdoren në jetën e përditshme sipas vetive dhe shndërrimeve të tyre.
<i>Java e dhjetë:</i>	Punë praktike 1: Përmes lojërave dhe përdorimit të lodrave identifikon dhe hulumton tiparet themelore të botës së gjallë, ndërtimit dhe funksionit të organizmit të njeriut dhe qenieve të tjera të gjalla, zinxhirët e ushqimit dhe rolin e mikroorganizmave në mjedis. Gjithashtu demonstrohen mënyrat për ruajtjen e ushqimeve, konsumimin e sigurt të tyre dhe efektet e substancave të dëmshme për organizmin (duhani, alkooli dhe pijet energjetike).
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Punë praktike 2: Proceset fizike – me anë të lojërave demonstron markimi (identifikimi) i vendndodhjes së objekteve përmes përdorimit të teknologjisë informative, përcaktimi i formës dhe masës së objekteve, matja e distancave dhe madhësive të caktuar, demonstrimi i njësive matëse dhe vëllimit të trupave të caktuar. Shtjellimi i temës nga lënda e Njeriu dhe Natyra – orientimi në natyrë: organizimi i lojës duke përdorur figura apo objekte të caktuar.
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Punë praktike 3: Toka, mjedisi dhe gjithësia – me anë të lojërave dhe figurave gjeometrike demonstron vendndodhja e tokës në sistemin diellor, si dhe bëhet renditja e planetëve e trupave tjerë në kuadrin e sistemit Diellor. Analizohet forma e tokës, pjerrtësia e rrezeve të diellit, përcaktimi i zonave të kohës dhe rrotullimi i tokës rreth boshtit të vet dhe rreth Diellit. Gjithashtu demonstron shtresat e brendshme të tokës (shkëmbinjtë dhe mineralet) duke identifikuar në praktikë: malet, fushat,

	lumenjtë, liqenet, detet, etj. Analizohen përbërësit e atmosferës dhe hidrosferës, si dhe diskutohen bashkëveprimi i botës së gjallë me mbështjellësit e tjerë të tokës.
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Punë praktike 4: nga lëndë specifike - organizimi i lojës me figura: duke përdorur lodra, objekte të tjera, pemë apo hapësirën e gjelbër, merr shembuj konkret në formë të figurave gjeometrike për të shtjelluar një dukuri të caktuar. Shembulli 1: Përdor pemët për të identifikuar bashkësitë dhe elementet e saj; Shembulli 2: Përdor trungu e pemëve dhe gjethet e tyre për të evidentuar trungun e familjes së nxënësve. Shembulli 3: përcakto emrat e përgjithshëm dhe të përveshëm duke përdorur botën bimore / shtazore të rrethinës apo parkut ku mbahet ora mësimore në natyrë. Shembulli 4: Planifiko veshjen e nxënësve dhe ngjyrat e përdoruar për të përcaktuar elementet e kulturës. Etj.
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Vlerësimi i njohurive përmes kollokviumit të parë
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Kujdesi dhe vetëdijesimi për mjedisi: Organizo leksionet në formë të aksionit vullnetar me nxënësit dhe komunitetin për pastrimin e mjedisit dhe mbjelljen e fidanëve të reja.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

- *Studentët janë të obliguar të përcjellin ligjëratat dhe të kryejnë detyrat praktike. Nëse studenti mungon për tri javë nuk i nënshtrohet vlerësimit dhe detyrohet ta dëgjoj përsëri lëndën në vitin vijues. Të gjitha punët, por edhe pjesëmarrja në ligjëratat dhe ushtrime janë pjesë e vlerësimit përfundimtar.*
- *Studenti është i obliguar ta bej prezantimin në kohën e caktuar nga mësimdhënësi. Mungesa në ditën e prezantimit nuk mund të kompensohet*
- *Detyrat dorëzohen me datën e caktuar nga mësimdhënësi. Detyrat e dorëzuara pas kësaj kohe nuk merren në konsideratë.*
- *Studentët janë të lirë të bëjnë pyetje dhe të marrin pjesë në çdo aktivitetet.*
- *Gjatë orëve mësimore dhe provimeve nuk lejohet përdorimi i telefonave celularë.*
- *Nuk lejohet ardhja me vonesë apo largimi nga ora pa arsye*

Mënyra e poenëve në vlerësim

Vlerësimi i parë (I): Gjithsejtë pikë 70: **Notë 10** (66 deri 70), **Notë 9** (61 deri 65), **Notë 8** (56 deri 60), **Notë 7** (51 deri 55), **No3të 6** (45 deri 50).

Vlerësimi i dytë (II): Gjithsejtë pikë 70: **Notë 10** (66 deri 70), **Notë 9** (61 deri 65), **Notë 8** (56 deri 60), **Notë 7** (51 deri 55), **Notë 6** (45 deri 50).

Provimi me shkrim: Gjithsejtë pikë 100: **Notë 10** (91 deri 100), **Notë 9** (81 deri 90), **Notë 8** (71 deri 80), **Notë 7** (61 deri 70), **Notë 6** (51 deri 60).

Vërejtje: nëse mënyra e poentimit ndryshon sipas sistemit të pyetjeve, ndryshon edhe vlerësimi i pikëve në mënyrë proporcionale, me qëllim që të kalkulohet 50% e poenëve pozitiv në vlerësim.

e-mail: tomor.qela@uni-pr.edu;

Tel: +38344509804

Evidenca e aktiviteteve të studentit

Vlerësimi në % (poenë)			10	10	10	35	35	100	Vlerësimi final	
			Aktiviteti i studentëve gjatë leksioneve	Asistenti	Prof. & Asis.	Profesori			Prof. & Asis.	
ID	Emri	Mbiemri		Detyre kursi	Prezantimi	Vlerësimi 1	Vlerësimi 2	Testi i përgjithshëm	Total pikë	Nota
XX	XXXX	XXXXXX	10	10	10	35	35	"	91	10
XX	XXXX	XXXXXX	10	10	5	30	35	"	90	9
"	"	"	"	"	"	"	"	"	"	"